



Komuna e Klinës

Kryetari i Komunës

01Nr. 870-32814/2022

Klinë, dt. 19.09/2022

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, publikuar në Gazetën Zyrtare, me dt. 04.06.2008, nr.28, dispozitat e nenit 5 dhe 6 të Rregullores së MAPL-së nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, dispozitat e nenit 91 të Statutit të Komunës së Klinës të vitit 2010, Kryetari i Komunës së Klinës, më dt. 19.09.2022, mori;

V E N D I M

*Për formimin e grupit punues për hartimin e draft Planit Komunal
për Menaxhimin e Fatkeqësive*

1. **CAKTOHET**, grupi punues për hartimin e projekt propozimit- Draft Planit Komunal për Menaxhimin e Fatkeqësive. Përbërja e grupit punues do të jete si në vijim:
 - 1.1. **Marqe Selmanaj**, kryesuese;
 - 1.2. **Qendrim Millaku**, anëtarë;
 - 1.3. **Shendrit Gashi**, zyrtar përgjegjës;
 - 1.4. **Astrit Muhaxheri**, anëtarë, si dhe;
 - 1.5. **Driton Berisha**, anëtarë.
2. Grupi punues është përgjegjës për hartimin e projekt propozimit të përmendur si në pikën 1 të këtij vendimi, marrjen e propozimeve dhe komenteve nga diskutimet publike dhe vendosjen lidhur me pranimin apo jo të tyre, hartimin e raportit të shqyrtimit publik, si dhe obligimet tjera që dalin nga dispozitat e Udhëzimit Administrativ të MAPL-së, nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, si dhe autorizimeve tjera ligjore e nënligjore.
3. Më rastin e përgatitjes së draft dokumentit dhe përfundimit të procedurave të nevojshme i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.
4. Ky vendim është i plotfuqishëm dhe hynë në fuqi menjëherë.

Te njoftohen:

- Te përmendurit;
- Drejtoria e SHPE;
- Zyrtarja përgjegjëse e konsultimeve publike, si dhe;
- Arkivi.

Kryetari,
Zenun Eleza

